



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 27.03.2025.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.03.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EUROCOM" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-133-211, **nxjerr:**

**V E N D I M**

**1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "EUROCOM" SH.P.K., e dt.25.03.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-133-211, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 20.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

**2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 20.03.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik "EUROCOM" SH.P.K. me dt.25.03.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi dhe ekzekutimi i objekteve pa leje në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-12691-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-133-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.03.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me formulën (sipas jush të formuluar gabimisht nga autoriteti kontraktues) nuk qëndron, sepse ju jeni përgjegjës që të kontrolloni ofertën tuaj- formulën dhe të kërkonit sqarime shtesë para hapjes së tenderit;

Pretendimi juaj lidhur me ndërhyrjen e OE "Horn& Co.Kosova" sh.p.k. dhe GOE "Berisha Com" shpk & "Vizion Plus" sh.p.k., nuk qëndron, sepse të njëjtit nuk kanë bërë përmirësimin/ ndërhyrjen në paramasë(njësi dhe sasi), por kanë korrigjuar formulën e cila nuk paraqet shkelje dhe të cilin veprim keni mundur ta bëni edhe ju ose të kërkonit sqarime shtesë para hapjes së tenderit. Gjithashtu sqarojmë se krijimi i formulës në EXCEL, nuk është në përgjegjësinë e Autoritetit kontraktues;

Pretendimi juaj lidhur me kontratën e qirasë në mes OE "Berisha Com" shpk dhe NNT"BINI" sh.p.k., ku dyshimi juaj ka të bëjë me numrin unik të NNT"BINI" sh.p.k., nuk qëndron, sepse në momentin që një biznes kalon nga biznesi individual në Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, detyrimisht që NUI do të ndryshoj;

Që një aktivitet të kalojë nga biznesi individual në Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, duhet që së pari biznesi ekzistues të shuhet në mënyrë që të krijohet i ri. Në këtë rast NNT"BINI" sh.p.k. si biznes individual është shuar me dt.12.06.2019 dhe po të njëjtën ditë (12.06.2019) është regjistruar si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është aktive;

Pretendimi juaj se pesha e BULDOZHER TG 80, nuk mund të jetë 6000 kg, nuk qëndron, sepse Grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë ka prezantuar DUD doganor në të cilin shkruan se pesha e BULDOZHER TG 80 është 6000kg ( e lëshuar nga dogana) dhe këtë Autoriteti kontraktues e merr si të mirëqenë;

Pretendimi juaj lidhur me përvojën e punës së ing.elektroteknikës Xhenifer Kryesiu, nuk qëndron, sepse në FDT-ë, nuk është kërkuar që të prezantohen referenca për tre vjet përvojë pune pas diplomimit por është kërkuar kontratë e punës , diplomë ,në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër të specifikohet titulli i projektit dhe CV (nga ku shihet se e njëjta ka shumë vite përvojë pune pas diplomimit):

**Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier I diplomuar apo master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv me tri vjet provoj pune pas diplomimit. b.) një inxhinier I diplomuar apo master drejtimi elektroteknikë me 3 vjet provoj pune pas diplomimit. c.) një gjeodet i licensuar me 3 vjet provoj pune pas diplomimit.**

**Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani., për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin.**

OF KO  
Kopimi  
Komuniteti  
Kopimi

Pretendimi juaj lidhur me ing.gjeodezisë Rinor Krasniqi, nuk qëndro, sepse në CV e tij nuk ka prezantuar përvojën e punës dhe Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime me nenin 72 të LPP-së, sepse:

|                                                                           |                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----|
| CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos | Mund të kërkojen informata sqaruese | 69 |
|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----|

Pretendimi juaj lidhur me pagat e punëtorëve mes OE "Berisha Com" shpk dhe të punësuarve të tij, nuk qëndron, sepse nuk është kompetencë e Autoritetit kontraktues, kjo është marrëdhënie që u takon dhe rregullohet mes dy palëve në fjalë;

Pretendimi juaj lidhur me ndërhyrjen e OE "Horn& Co.Kosova" sh.p.k. në formulë nuk qëndron sepse i njëjti nuk ka bërë përmirësimin/ ndërhyrjen në paramasë(njësi dhe sasi), por ka korrigjuar formulën e cila nuk paraqet shkelje dhe të cilin veprim keni mundur ta bëni edhe ju;

Pretendimi juaj për OE "REA" sh.p.k., nuk qëndron, sepse në momentin që një Operator ekonomik nuk prezanton Sigurimin e tenderit automatikisht oferta e tij refuzohet pa shiquar dokumentet tjera të ofertës së tij;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

